Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

234/22
29.06.22
PRISHTINË - PRIŠTINA

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Visar Kastrati	28.06.2022	29.06.2022	234/22
Emri dhe Mbiemri i ekspertit shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	*Nr. i lëndës*

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 27.06.2022, OE N.N.P. "STUDIO LINKS 4 "- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr.: 234/22, kundër njoftimit mbi vendimin e AK-së të aktivitetit të prokurimit: "Hartimi i draft Planit Komunal te veprimit per Energji dhe Klimë" me nr. të prokurimit: 622-22-2273-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT.
Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbime, vlera e parashikuar e kontratës: 30,000.00€.
Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Dispozitat e shkelura
Neni 1 dhe 7
Neni 59
Neni 4 paragrafi 1.19
Pyetjet e shpeshta nr.46
24.10 te RRUOP

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet
A.K. ka bere shkelje e nenve te cekura me lart ;
Kompania Studio LINKS 4, BI, Nafije Gashi Ademi, duhet te jete fituese me të drejtë e këtij tenderi sepse jemi të përgjegjshëm në të gjitha pikat dhe jemi më të lirët me cmim.
Arsyetimi i juaj nuk qendron sepse paramasa jone nuk ka gabime aritmetike. AKEREE ka bere shkelje

duke mos vendosur kuoten per TVSh qe eshte ne shperputhje me Nenin 4 paragrafi 1.19 LPP.
AK sipas Nenit 7 duhet qe te gjithe OE t'i trajtoj te barabarte ne nje aktivitet prokurimi. Nuk mundet qe per shkak te OJQ-se te ciles nuk ia ka ndare TVSH-ne te tjeret t'i diskriminoj me ane te vleres se TVSH. AK nuk guxon ta perdore TVSH-ne te zbritshme per nje OJQ ndersa per OE te pazbritshme. Norma e TVSH-se duhet te paracaktohet ne dosje te tenderit (Ne rast se keni kerkuar qe TVSH te perfshihet ne paramasen e qmimeve, aty nuk ka pasur vend per t'u shkruajtur TVSH per dallim prej Komunes se Ferizajit (tenderi i njejte) e cila e ka specifikuar ne paramase qe cmimet jane me TVSH.) Kur nje tender sikur ky me donatore nuk parasheh TVSH-ne le te kuptoj qe donatori nuk do ta paguaj TVSH-ne,por kjo duhet te ceket sepse krijon amulli.
Prandaj OE STUDIO LINKS pa TVSh ka vleren 8,900 euro ndersa nese eshte me buxhet te Kosoves e keni vleren me TVSH prej 10,502euro. Prandaj jemi me te liret. Por sido qe te jete Ak ka qene dashtur ta sqaroj

Neni 7. A.K. ke bere shkelje te nenit 7 sepse ka bere diskriminim me vendim jo te drejte ndaj Operatorit Ekonomik me te lire me cmim (Studio LINKS 4) kur e anulon studio LINKS 4 në arsyetimin e gabimit aritmetikor më të madh se 2%.
Lista e cmimeve ose Pershkrimi i cmimeve nuk ka pasur fusha te mbyllura dhe fusha te shenuara per tu plotesuar nga OE ne lidhje me TVSH.

AK Është dashur t'i referohet nenit 24.10 te RRUOP ku thuhet:

> **24.10 Lista e çmimeve e standardizuar është një Liste e çmimeve që gjenerohet nga sistemi dhe përmban elemente të paracaktuara të Listës se çmimeve. Kjo Liste e çmimeve shkarkohet nga faqja e internetit të Prokurimit Publik Elektronik në Kosovë. Lista e çmimeve e standardizuar gjenerohet në formë të standardizuar të Excel-it ose kjo liste mund të plotësohet direkt në formën e sistemit ose, ne rast se kjo e liste e standardizuar nuk i plotëson nevojat (specifikat e ndryshme) e AK, AK mund të krijoj një liste të re. Pas plotësimit dhe ngarkimit, Lista e çmimeve e standardizuar shndërrohet në një format të Listës se çmimeve e cila është e përshtatshme për tenderuesit, me fusha të mbyllura të përcaktuara nga autoriteti kontraktues dhe me fushat e shënuara për tu plotësuar nga ofertuesit:**
> - **Çmim për njësi**
> - **Norma e TVSH-së**
> - **Emri i prodhuesit**
> - **Shënimi i Ofertuesit**

Në përshkrimin e cmimit Lista e cmimeve nuk ka pasur Normën e TVSH-së dhe rrjedhimisht ka qenë në kundërshtim me RRUOP sepse Lista e cmimeve duhet të përmbaj Normën e TVSH-së. AK nuk ka thene qe norma e TVSH-se perfshihet ne cmim apo nuk perfshihet por ka harruar ose me qellim nuk e ka vendosur fushen e shenuar per tu plotesuar nga ofertuesi.

Andaj bazuar në pyetjet e shpeshta:

Pytja e shpesht nr.46 citat: - Në rast se një Operator Ekonomik ofron një çmim ku % (përqindja) e TVSH-ës është e gabuar (më e lartë apo më e ultë se norma e aplikueshme e TVSH-ës) Autoriteti Kontraktues do ta korrigjoj % (përqindjen) e atij apo atyre artikujve në bazë të normës së aplikueshme të TVSH-ës pa pasur nevojë të kërkoj sqarime shtesë nga Operatori Ekonomik në fjalë

Ne mendojmë që AK është dashur të konsultohet me Pyetjet e shpeshta nr. 46 dhe të mos e eliminoj OE më të lirë në cmim vetëm sa për t'i dhënë kontratën gabimisht OJQ- së të cilën e trajton si OJQ ne kundëshrshtim me inërpretimin e KRPP (bashkangjitur) ku thuhet qe OJQ ne aktivitetet e prokurimi duhet te trajtohet si OE – Neni 4 paragrafi 1.19.

Cmimin që ne kemi vendosur në Listën e cmimeve ka qenë në përputhje me RRUOP dhe aty ku nuk ka ekzistuar Norma e TVSH-së ne nuk e kemi vendosur normën e TVSH-së. Por pastaj Listës së cmimeve i është shtuar norma e TVSH-së në sistemin e-prokurimi në fushën e caktuar dhe në të vetmin vend ku e dosja e tenderit e ka kerkuar. Shiheni ju lutem Hapjen e cmimeve.
Fakti qe ne kete aktivitet te prokurimit jane ftuar te konkurojne edhe OJQ-te te cilat nuk kane ofertuar TVSH mendoj qe Lista e cmimeve iu eshte pershtatur atyre. (ju lutem shiqojeni ofertuesin AKEREE i cili eshte OJQ dhe eshte shpallur fitues ndersa ka injoruar teresisht TVSH-ne)

Kerkojme qe OSHP te na shpalle fitues neve si OE dhe OJQ AKEREE te trajtohet si OE ne perputhje me ligjin.
Lista e cmimeve nuk ka permbajtur kutine per TVSh dhe ne si OE e kemi vendosur TVSh aty ku eshte kerkuar ne sistemin e – prokurimi prandaj jemi me te liret dhe ne perputhje me ligjin.
Kerkojme te shpallemi fitues dhe jo te eliminohemi.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat

Kërkesa 1:
Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit; Rexhistrimi i numrit fiskal

Dëshmia Dokumentare

Dëshmia 1:
Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (PER ojq DUHET CERTIFIKATA E ojq-SE) (Kopja e certifikatës së biznesit); Kopja e numrit fiskal

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

1. Oe; Albo Group SH.P.K. i mungojn; Ing indertimtaris i mungon pervoja e punes jo e kenaqshme, nuk ka deshmaur pervoje ne hartimin e planeve te EE-se dhe 2. Ing i architektures mungon pervoja e punes.

2. OE;" EVERLIGHT" SH.P.K. Ing i prezantuar zt Agim Saliu i mungon diploma e shkollimit; dhe Ecc i dipl i muugon referenca e punes.
3. OE;Grup i Operatoreve Ekonomik N.N.P. STUDIO LlNKS 4; Aida Gashi Krasniqi B.I.; gjate ekzamiuimit dhe vleresimit te ofertave komisioni koustaton se;GOE; gjate plotesimit te formularit per dorezimin e tenderit dhe plotesimit te paramsave dhe parallogarive eshte konstatuar se ka cmimve te ndryshme gje qe e tejkalon pragun prej +- 2% te gabimeve arimetikore. Ne formular te dorezimit te tenderit shume e vendosur eshte 10502.00 euro ndersa gjate kaklkulimit te paramasave totali eshte 8900.00 euro Komisioni i vleresimit te ofertave rekomandon qe OE i lartecekur duhet te eleminohet si OE i papergjegjshem,
4. OZON space SH.P.K. i mungojn;3.CV e te pakten 4 inxhiniereve, me arsim perkates me diplome bachelor ne fushat inxhinierike dhe ate 2 inxhinier I arkitektures ose ndertimtarise 1 inxhinier i elektrikes 1 inxhinier i makinerise me 2 vjet përvoje, ose diplome master me se paku 1 vjet përvojë në efiçiencën e energjisë, apo burimet e ripërtritshme te energjisë ose klimën. Referencat i basbkangjiten CV-se. (Shenim pervoja perkatese do te konsiderohet referenca teknike për mbikeqyrjen ose zbatimin e projekteve te zbatimit te masave te EE, hartimin e planeve projekteve ne fushen e EE, apo BRE - ve ose klimës). 4.Nje ekonomist, me min. 3 vjet përvojë ne fushën profesionale qe ka te beje me vlerësimin e projekteve investive, me arsim përkatës te paktën master ose diplome ekuivalente ne ekonomi. I gjithë stafi i prezantuar ne dosje ju mungojn referencat e punes.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

N/A

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES OE N.N.P. " STUDIO LINKS 4 "

Pretendimet ankimore të OE ankues kanë të bëjnë me ankesën e dërguar në OSHP me datë 27.06.2022.

Përgjigje në pretendimin ankimor nr. 1

Pretendimi ankimor ka të bëjë me atë se në formularin e përshkrimit të çmimit, ku nuk është paraqitur kolona ku duhet të paraqitet norma e TVSH-së.

AK në formularin e çmimeve në dokumentin e ngarkuar në platformën e E-Prokurimit *"Paramasa dhe parallogaria - PKVEK finale"*, nuk ka vendosur kolonën për të paraqitur normën e TVSH-së.
Bazuar në kërkesat që dalin nga Rregullat dhe udhëzuesi operativ për prokurimin publik (RRUOPP), përkatësisht neni 24.10 lidhur me listën e standardizuar të çmimeve, AK është i obliguar ta bëjë këtë. Shprehimisht, nga neni i sipërpërmendur kërkohet që AK duhet të vendos fushat e shënuara për tu plotësuar nga ofertuesit, dhe ato janë si në vijim: çmim për njësi, norma e TVSH-së, emri i prodhuesit, shënimi i Ofertuesit etj.

Për më tepër, tek parashikimi i vlerës dhe klasifikimi i kontratës, përkatësisht neni 13.18 i RRUOPP thuhet se: *"Në raste kur ka ndryshime sipas një vendimi të një organi kompetent, në tatime, normën e TVSH-së apo ndryshime në tarifat për import, çmimet e kontratës duhet të rregullohen në përputhje me rrethanat."*. AK në dosjen e tenderit dhe në formularin çmimit, në asnjë rast nuk e ka dhënë arsyetimin, pse kolona për normën e TVSH-së nuk është e përfshirë.

Nga mangësitë e tilla të evidentuara në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë, është e pamundur të bëhet një vlerësim i drejtë, prandaj vazhdimi i këtij aktiviteti, hap mundësinë e një shkelje të ligjit që ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi i cili mund të bëhet në këtë fazë. Prandaj, bazuar në sqarimet e mësipërme ***pretendimi ankimor është i bazuar.***

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues ***të aprovohet si e bazuar***, rekomandon që të anulohet njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe aktiviteti të kthehet në ***ri-tenderim***.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – OE N.N.P. " STUDIO LINKS 4 "- Prishtinë